

Tiranë, më 20.5.2025

Njoftim për shtyp

Në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit vijoi shqyrtimi gjyqësor i ankimit kundër vendimit nr. 760, datë 26.4.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Ardiana Bera, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Gjatë verifikimit të prezencës së palëve, kryesuesja e seancës konstatoi mosprezencën e subjektit të rivlerësimit dhe të përfaqësuesit të autorizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

Në vijim, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, vendosi:

Ndryshimin e vendimit nr. 760, datë 26.4.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Ardiana Bera.

Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 20.5.2025

Ankimi dhe parashtrimet janë publikuar në faqen zyrtare të SPAK, në rubrikën “Procesi i rivlerësimit”: <https://spak.gov.al/>

Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, referuar nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ushtron kompetencat e Komisionerëve Publikë, që prej datës 1.1.2025.